

KONTRATE SHITBLERJEJE



SHITESI : **GIUSEPPE SARVIA**, i biri i Giacomos dhe Maries, lindur me 17.07.1956 ne Fossano, banues ne via Chiarini N. 10, CAP 12045, FOSSANO (CN) - ITALI, me pasaporte N. 750619 G.

BLERESIT: **1.PAOLO MELLANO**,i biri i Micheles dhe Marias, lindur me 15.07.1963 ne Fossano, banues ne Corso Francia N.125, Cap.12100, CUNEO - ITALI, me pasaporte N. 856751.
2.RAF PILIKA, i biri i Rikos dhe Elianes, lindur me 25.03.1972 ne Tirane, banues ne rrugen Hoxhe Vokrri P.19/1 Ap.3, TIRANE - SHQIPERI, me leter njoftimi N.QH331276

deklarojne se bejne kete kontrate shitblerjeje kuotash per te futur si ortake ne shoqerine A Bi Esse sh.p.k. Paolo Mellanon dhe Raf Piliken.

Giuseppe Sarvia eshte ortak ne shoqerine A Bi Esse sh.p.k, te rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, me numer vendimi 11918, me date 24.08.1995, qe ka ndryshuar pjesemarrjen ne kapitalin themeltar me vendimin e Gjykates nr.11918/1 te dates 27.07.1996. Ai zoteron 37.5 kuota, nga kuota me numer 1 - 37.5. Vlera nominale e seciles kuote eshte 1000 leke, pra ai zoteron nje vlere prej 37 500 lekesh.

Sipas vendimit te asamblese se ortakeve te dates 25.10.1996, ai ka vendosur te mbaje vete 10 kuota, nga numri 1 - 10 dhe t'i shese 15 kuota, nga numri 11 - 25, Paolo Mellanos, per nje vlere prej 15 000 lekesh dhe 12.5 kuota, nga numri 26 - 37.5, Raf Pilikes, per nje vlere prej 12 500 lekesh.

Paolo Mellano deklaroi se eshte dakord te bleje 15 kuota, nga numri 11 - 25, nga kuotat e Giuseppe Sarvias, per nje vlere prej 15 000 lekesh, duke u futur si ortak ne shoqerine A Bi Esse.

Raf Pilika deklaroi se eshte dakord te bleje 12.5 kuota, nga kuota 26 -37.5, nga kuotat e Giuseppe Sarvias, per nje vlere prej 12 500 lekesh, duke u futur si ortak ne shoqerine A Bi Esse.

Mbas shitblerjes se kuotave, ortaket do te zoterojne perkatesisht:



GIUSEPPE SARVIA zoteron kuotat nga 1 - 10, d.m.th. 10 % te kapitalit,
PAOLO MELLANO zoteron kuotat nga 11 - 25, d.m.th. 15 % te kapitalit,
RAF PILIKA zoteron kuotat nga 26 - 37.5, d.m.th. 12.5 % te kapitalit.

Kjo kontrate shitblerjeje u hartua ne tri kopje me fuqi te barabarta ligjore dhe, pasi u lexua e u ra dakord midis paleve, u nenshkrua prej tyre rregullisht.

SHITESI

Giuseppe Sarvia

BLERESIT

Paolo Mellano

Raf Pilika